



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Pranuar - Primesha NënÇanta *09.02.2012*

Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtesa Prilog	Vlera Vrednost
<i>01-013/140</i>			

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenin 40.2 pika g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 2008/28, nenit 2.3 dhe 8 të Ligjit nr 03/L-049 për Financat e pushtetit lokal ( G. zyrtare nr 27/2008) dhe nenit 35.2 pika g) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01- 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 06.02.2012 aprovon këtë:

## V E N D I M

PËR PEZULLIMIN E PËRKOHËSHËM TË ZBATIMIT TË NENIT 20 TË  
RREGULLORES KOMUNALE PËR NGARKESA, TAKSA DHE GJOBA  
NR 01-013/806 TË DATËS 09.06.2011

### Neni 1

Me qëllim të krijimit të kushteve më të favorshme për zhvillimin e bizneseve në Komunën e Vitisë, Kuvendi i Komunës së Vitisë APROVON Vendimin për lirim nga pagesa e taksës komunale për të gjitha subjektet afariste të Komunës së Vitisë të parapara në nenin 20 të Rregullores komunale për ngarkesa, taksa dhe gjoja, duke filluar prej 01.01.2012 deri më 31.12.2014 përkatësisht PEZULLOHET për tri vite zbatimi i nenit 20 të Rregullores komunale për ngarkesa, taksa dhe gjoja numër 01-013/806 të datës 09.06.2011.

### Neni 2

Obligimet e pa paguara të subjekteve afariste sipas neni 20 të Rregullores komunale për ngarkesa, taksa dhe gjoja deri më 31.12.2011 nuk shlyhen, por pezullohen për pagesë për tri vite, përkatësisht pezullohen për pagim për vitin 2012, 2013 dhe 2014.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim i Komunës së Vitisë.

### Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë dhe do të zbatohet nga 1 Janari 2012 deri më 31.12.2014.

Vendimi i dërgohet:

1. Drejtorisë për Financa,
2. Arkivit,

KRYESUESI I KUVENDIT  
Skenderbe Hebib

